

Vendim nr. 231 datë 23.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 23.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PETRIT NDOJ**, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ndoj me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 206, datë 02.11.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-2143, datë 24.12.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë ose në Gjykatën e Lartë, me një tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, pika 2, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 39, 45, 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2013 kërkuesi së bashku me të tjerë kanë paraqitur kallëzim penal ndaj disa punonjësve të Bashkisë Lezhë, me pretendimin se kanë kryer veprime abuzive për sa i takon ndërtimit të rrugës që kalon në zonën e tyre të banimit, si pasojë e së cilës atyre u janë prishur ndërtime të cilat kanë qenë në proces legalizimi.

2. Sipas kallëzuesve, në vitin 2003, Bashkia Lezhë ka prezantuar një studim pjesor për zhvillimin urban të zonës së tyre, referuar të cilit ata kanë kryer ndërtime, për të cilat kanë filluar procedurat e legalizimit. Pas 7 vjetëve, në vitin 2010, bashkia ka bërë rishikimin e studimit dhe ka hartuar projektin për asfaltimin e rrugës, i cili është miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit (*KRRT*). Ndërkohë bashkia ka pretenduar se që nga viti 2003, kur është hartuar studimi, janë shtuar shumë ndërtime dhe po të zbatoheshin ai studim duhet të prisheshin tre objekte banimi me certifikatë pronësie, ndërsa sipas projektit të vitit 2010 nuk dëmtohen objekte banimi, por prishen vetëm mure rrethuese, ashtu sikurse është vepruar, kurse gjurma e rrugës është ruajtur e paprekur. Nga verifikimi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, muret rrethuese dhe objektet e tjera që u janë prishur kallëzuesve nuk kanë pasur dokumente pronësie.

3. Fillimisht, Prokuroria e Lezhës, në datën 20.12.2013, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kallëzuesit mund t’i drejtohen gjykatës për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

4. Gjithashtu, për këto fakte kërkuesi ka paraqitur edhe padi në gjykatë për anulimin e vendimeve të *KRRT*-së, duke kërkuar njëkohësisht edhe sigurimin e padisë për pezullimin e shembjes e ndërtimeve. Ndonëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e datës 11.09.2013, ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë, ndërtimet janë shembur nga ana e bashkisë. Për veprimet e shembjes, prokuroria ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës në ngarkim të një punonjësi të Bashkisë Lezhë.

5. Ndërkohë, pranë prokurorisë janë regjistruar disa procedime penale për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pengime të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës”, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e projektit për ndërtimin e rrugës. Pas bashkimit të tyre në një procedim të vetëm, prokuroria në vitin 2014 ka disponuar pushimin e çështjes. Po kështu, megjithëse gjykata e apelit ka prishur vendimin e prokurorisë dhe ka urdhëruar fillimin e hetimeve, përsëri prokuroria, me vendimin e datës 30.07.2016, ka vendosur pushimin e çështjes. Ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. 1, datë 13.02.2017, e cila i ka lënë detyrë prokurorisë të kryejë hetime të mëtejshme për procedurat e shpronësimit dhe nëse ato janë përfunduar përpara fillimit të punimeve dhe prishjes së objekteve, si dhe detyra të tjera lidhur me çështjen.

6. Në vijim, organi i akuzës ka proceduar me kryerjen e veprimeve hetimore sipas drejtimeve të lëna nga gjykata, përfshirë edhe riekspertimin topografik dhe në përfundim ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 16-53-2020-451, datë 26.02.2020, ka vendosur pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ndonëse pala kallëzuese, përfshirë edhe kërkuesin, ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 206, datë 02.11.2020, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala kallëzuese.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2143, datë 24.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së.

8. Në datën 16.06.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi pretendimet janë trajtuar vetëm formalisht. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kallëzimit për

ndryshimin e projektit të vitit 2003 në vitin 2010. Vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor kur shprehet se hetimi ka qenë i plotë, ndonëse prokuroria nuk ka zbatuar detyrat e caktuara nga gjykata; ndërtimet janë shembur, ndërsa gjykata shprehet se nuk janë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetasve. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit në rekurs për mosarsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit; arsyetimi i saj është i shkurtër; pretendimet e kallëzuesve nuk janë për vlerësime provash, ndaj rekursi duhet të ishte marrë në shqyrtim; hetimet për çështjen kanë qenë me të meta, ndaj duhet të ishin kryer veprime hetimore shtesë.

- 9.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi nga zbatimi i projektit kërkuesit i është zënë një pjesë e konsiderueshme e pronës, duke i shembur murin rrethues dhe dëmtuar disa pemë frutore, pa u respektuar procedurat për shpronësimin e pronës. Ai është zhveshur në mënyrë të paligjshme nga pronësia nga një investim publik dhe në mënyrë hakmarrëse punonjësit e bashkisë e kanë përjashtuar nga lista e përfituesve të shpronësimit për interes publik. Refuzimi i prokurorisë dhe i gjykatave të zakonshme për të vijuar hetimin e pushtimit pa ligj të pronës së tij përbën shkelje të detyrimit kushtetues për mbrojtjen e së drejtës së pronës.
- 9.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese nga Gjykata e Lartë në raport me çështjet e tjera, duke kryer një interpretim diametralisht të ndryshëm të shkaqeve ligjore të rekursit dhe duke vendosur në mënyrë të padrejtë mospranimin e rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me

shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aspektit substancial, individit duhet të provojë se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e veprave penale që ndiqen kryesisht nga organi i prokurorisë, pa pasur nevojën e kërkesës ose të ankimit të viktimës, si rregull, gjykimi kushtetues nuk vihet në lëvizje nga kallëzuesi bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, përveçse kur kallëzuesi justifikon interesin individual, të drejtpërdrejtë dhe real, pra duke treguar të drejtën substanciale që i preket nga procedimi penal (*shih vendimet nr. 39, datë 17.02.2025; nr. 307, datë 17.12.2024; nr. 283, datë 25.11.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen konkrete, kërkuuesi ka kundërshtuar në të tria shkallët e gjyqësorit pushimin e procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës ndaj disa punonjësve të Bashkisë Lezhë, të kallëzuar prej tij dhe disa shtetas të tjerë. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, ai e justifikon interesin në çështjen e parashtruar. Për sa i takon interesit substancial, Kolegji vëren se vepra penale e shpërdorimit të detyrës, që është kallëzuar nga kërkuuesi, në thelb, i kundërvihet veprimtarisë shtetërore dhe kryhet nga punonjës shtetërorë ose në shërbim publik, siç është rasti i punonjësve të bashkisë. Për këtë arsye, është e rëndësishme të përcaktohet nëse kërkuuesi justifikon interesin individual, të drejtpërdrejtë dhe real për procedimin penal.

13. Nën këtë optikë, Kolegji konstaton se kërkuuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së pronës private përmes një procesi të parregullt ligjor, si pasojë e zbatimit të projektit nga Bashkia Lezhë për ndërtimin e një rruge, duke parashtruar argumentin se veprimet e paligjshme të kallëzuarve nuk janë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga prokuroria. Lidhur me procedimin penal, rezulton se prokuroria ka vlerësuar se faktet e kallëzuara nuk përbënin vepër penale, pasi çështja e prishjes së pronës mbetet tërësisht e karakterit civil dhe, si e tillë, mund të zgjidhet vetëm në gjykatë; muret dhe objektet e prishura nuk kanë qenë me leje ndërtimi dhe, si të

tilla, ishin të paligjshme; ndërsa çështja e veprimeve të paligjshme të një punonjësi të bashkisë, në kundërshtim me vendimin e gjykatës që kishte disponuar sigurimin e padisë, ishin objekt shqyrtimi i një procesi tjetër gjyqësor. Ky përfundim i prokurorisë është pranuar nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë lënë të pacenuar vendimin për pushimin e procedimit penal. Nga analiza e vendimeve gjyqësore, Kolegji çmon se nuk evidentohen gabime ligjore ose faktike në vlerësimin e prokurorisë dhe të gjykatave, të tilla që të vënë në dyshim konkluzionin e tyre.

14. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkuuesi e ka ngritur çështjen e shpërblimit të dëmit si pasojë e zbatimit të projektit për interes publik edhe në rrugë gjyqësore, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së tij, duke e dëmshpërblyer atë me 43.065.66 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuuesi. Kjo do të thotë se e drejta e pronës së kërkuetit është objekt i drejtpërdrejtë i proceseve gjyqësore civile ose administrative, dhe jo i procesit penal të kundërshtuar. Pra edhe në rastin e një vendimi fajësie për procedimin penal në fjalë, nuk rezulton që kërkuuesi do të zhdëmtohej pa ngritur një padi civile për shpërblimin e dëmit.

15. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuuesi nuk justifikon interesin e drejtpërdrejtë, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.